



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, neneve 14 dhe 15 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, në zbatim të Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 2019 – 2023 në Komunën e Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 09 shtator 2020, mori,

VENDIM

Neni 1

Mbështet për vënie në diskutim publik:

- ***Propozim Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës.***

Neni 2

Diskutimi publik sipas nenit 1, për shkak të situatës së krijuar nga Pandemia Covid-19 dhe pamundësisë së mbajtjes së tubimeve publike me komunitetet e fshatrave dhe lagjeve urbane, pezullohet në kohë të pacaktuar, përkatësisht deri në përmirësimin e situatës epidemiologjike dhe krijimit të kushteve për organizimin dhe mbajtjen e tubimeve publike, që do të caktohet me një vendim tjetër nga Kuvendi i Komunës.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Draft Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.01-060/01-0055328/20
Podujevë,
09 shtator 2020



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi